

VENDIM
Nr.187, datë 10.4.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.289, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET DHE PËRBËRJEN E KËSHILLAVE MBIKËQYRËS TË
SHOQËRIVE ANONIME SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.8885, datë 22.4.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare””, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.289, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Në pikën 7 fjalët “Këshilli i Ministrave...” zëvendësohen me “Kryeministri...”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano